

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.Zh. nga fshati Ll. Komuna e P., për shkak të dy veprave penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 dhe neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.3350-15/2012 dt.02.11.2011 dhe PP.nr.551/2014 të datës 18.01.2014, pas mbajtjes të seancës së shqyrtimit fillestar publik me datë 19.02.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Gjejrone Alaj, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. F. G.- B. nga P., me datë 22.02.2016, në prezencë të akuzuarit dhe prokurorit mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 07.03.2016 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari, SH. ZH.**, i biri i I. dhe nënës H., e vajzërisë A., i lindur më dt.*data e lindjes...*, në fshatin Ll., Komuna e P., ku edhe jeton, me numër personal të identifikimit: *numër personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar baba i tre (3) fëmijëve, nuk ka qenë i gjykuar më parë, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim prej datës **21.01.2014, e deri më datën 20.02.2014.**

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

**I.** Më dt.15.07.2010, rreth orës 21:15, në rrugën magjistrale Prishtinë-Podujevë, në fshatin “Lupç i Poshtëm”, Komuna e P., saktësisht te depoja e materialit ndërtimor “T. E.”, i pandehuri derisa ishte duke drejtuar automjetin e tipit “Fiat Uno”, me ngjyrë të gjelbër, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën dhe ka dëmtuar trupin e njeriut, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 54 par. 1, nenin 151 dhe 225.1 të ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor, duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve dhe rrethanave në rrugë si dhe duke mos kushtuar kujdesin gjatë lëvizjes me automjetin e tij në mënyrë që të ndalet me kohë dhe në distancë të mjaftueshme, ashtu që i pandehuri gjatë lëvizjes me automjetin e tij duke e vërejtur të dëmtuarën –këmbësoren E.H. që ishte duke kaluar rrugën, nga ana e majtë në të djathtë ku me pjesën ballore të anës së majtë të automjetit e godet në këmbën e djathtë tani të dëmtuarën-këmbësoren E.

H., me ç` rast e dëmtuara E. H., pëson lëndime të rënda trupore, me thyerje të regjionit të kockës së para llërës (kockës së dorës) së djathtë dhe plagë shqyese -shtypëse të regjionit të indeve të buta të kockës së njëjtë, para llërës (kockës së dorës) së djathtë si dhe lëndime të lehta trupore pëson bashkudhëtarja e tij tani e e dëmtuara H. S., me gjendje shëndetësore të rënduar të shtatzënisë, në javën e 27 e shoqëruar me dhimbje të lindjes ë parakohshme dhe me gjakderdhje ngjyrë të errët.

Me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

**II.I** pandehuri Sh. Zh., më 21.01.2014, rreth orës 19:30, në rrugën Prishtinë-Lluzhan-Orllan, më saktësisht në lagjen e S., në fshatin B. të Komunës së P., derisa e drejtonte automjetin e tij të markës Opel Vectra, me ngjyrë të bardhë me targa *numër i targave...*, duke menduar me mendjelehtësi se deri te aksidenti nuk do të vij, ka rrezikuar trafikun publik dhe ka vënë në rrezik jetën e pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, duke vepruar në kundërshtim me nenin 56 par. 1 si nenin 54 par. 1 dhe 225.1. të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, duke zhvilluar shpejtësinë jo adekuate me kushtet e komunikacionit në rrugë, pasi që moti ishte me shi dhe asfalti i lagur, si dhe duke tejkaluar shpejtësinë e lejuar brenda zonave të banuara, ashtu që derisa këmbësorët, F. S., Y. S. dhe B. S. ishin duke ecur skaj rrugës ( në pjesën e djathtë të rrugës), papritmas goditen me pjesën e parë frontale të automjetit të cilin e drejtonte tani i pandehuri Sh.Zh. dhe se nga goditjet lëndime të lehta trupore kanë pësuar F. S. dhe Y. S., kurse tani i ndjeri B. S. më vonë kishte vdekur në QKUK-së, në Prishtinë.

Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,17,23,41,42,43,45,73,74,80,83 par.1, nenit 378 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365,450,453,463,370 të KPPRK-së, për dy veprat penale veç e veç dënimet ia:

## **P Ë R C A K T O N**

Për veprën e parë si në dispozitivin në pikën **I**, të këtij aktgjykimi, e gjykon me dënim me burg, në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muaj**.

Për veprën e dytë si në dispozitivin në pikën **II**, të këtij aktgjykimi, e gjykon me dënim me burg në kohëzgjatje prej **një (1) viti e gjashtë (6) muaj**.

**Me aplikimin e nenit 80 të KPRK-së, e**

## **G J Y K O N**

**I.** Të akuzuarin Sh. (I.) Zh., me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej **1 (një) viti e tetë (8) muaj**, të cilin do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

**II.** Konform nenit 83 par.1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej **datës 21.01.2014. deri me datë 20.02.2014.**

**III.** Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej **90.88 € (nëntëdhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent)**, për gjashtë ekspertiza mjekoligjore dhe për dy ekspertiza të komunikacionit shumën prej **204.04 €, ( dyqind e katër euro e katër cent)**, ndërsa në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **100€ (njëqind/euro)**, në afatin prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

**IV.**E dëmtuara Familja e të ndjerit B. (I.) S. dhe të dëmtuarit tjerë F. (Z.) S., Y. (M.) S. nga fshati B. Komuna e P., E. (Sh.) H. nga fshati L. i P. Komuna e P., H. S. nga fshati Ll. Komuna e P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzat PP.nr.3350-15/2012 dt.02.11.2011 dhe PP.nr.551/2014 të datës 18.01.2014, kundër të akuzuarit Sh. (I.) Zh., për shkak të dy veprave penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 dhe 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 19.02.2016, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit Gjejrone Alaj nga Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, av. F.G.-B. nga P..

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.F. G.-B., ka deklaruar se në tërësi e pranon fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzave për dy veprat penale për të cilat akuzohet, dhe ka theksuar se ndien shumë keqardhje për familjen e të ndjerit B. S. duke ju kërkuar falje dhe falënderuar që e kanë falë, dhe ka shtuar se me mundësit e tij i ka ndihmuar familjen e të ndjerit, i premtoi gjykatës së në të ardhmen do të jetë shumë i kujdesshëm.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës e bëri rikualifikimin e veprës penale për aktakuzën PP.nr.3350-15/2010 dt.02.11.2011, dhe atë: nga vepra penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par 5 lidhur me par 3 dhe 1 të KPK-së, në vepër të njëjtë penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, si ligj më i favorshëm për kryesin, dhe ka bërë përmisimin-precizimin e dispozitivit të aktakuzës së PP.nr.551/2014 dt.02.04.2015, nga reshti i 8 (tetë) të përshkrimit faktik që duhet që të jetë: “derisa këmbësorët, F. S., Y.S.

dhe B. S. ishin duke ecur skaj rrugës ( në pjesën e djathtë të rrugës), papritmas goditen me pjesën e parë frontale të automjetit të cilin e drejtonte tani i pandehuri Sh.Zh. dhe se nga goditjet lëndime të lehta trupore kanë pësuar F. S. dhe Y. S., kurse tani i ndjeri B. S. më vonë kishte vdekur në QKUK-së” në Prishtinë”, dhe ka theksuar se në këtë kuptim eliminohet dispozitivi i dytë i kësaj aktakuze për shkak se vepra e parë e konsumon, dhe lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare, pa presion duke i kuptuar pasojat dhe natyrën e pranimin të fajësisë, i propozoj gjykatës që të aprovohet pranimi i fajësisë dhe të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit pasi që janë pajtuar me familjen.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.F. G. B. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se pranimi i fajësisë për dy vepra penale konsideroj se len hapësirë gjykatës që të aplikoj dispozitat e nenit 73,74,75,76, dhe 47 të KPRK-së, të mbrojturit tim për veprën penale me pasoja fatale ti shqiptohet një dënim nën minimumin e paraparë ligjor, sepse pranimi i fajësisë, pendimi, keqardhja, kanë qenë që nga momenti i parë me policinë dhe sot në gjykatë, ndërsa për veprën penale me pasoja të rënda trupore meqenëse u pranua fajësia të njëjtit ti epet një dënim i kushtëzuar apo edhe i zëvendësuar me gjobë që konsideroj se do ishte e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit, dhe me rastin e lartësisë së dënimit të ketë parasysh përveç pranimin të fajësisë, është mbajtës i vetëm i familjes baba i 3 fëmijëve dhe një dënim i ashpër eventual do ta godiste gjithë familjen.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht për dy veprat penale, gjykata e vlerësoi dhe analizoi se pranimi i fajësisë ka mbështetje në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të komunikacionit rrugor Ing. N. S. të datës 03.05.2011, dhe Ing. A. M. të datës 23.04.2014, po ashtu pranimi i fajësisë ka mbështetje në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve mjeko-ligjore Dr. N. U. të datës 14.09.2010, dhe Dr.Sci. F. B. të datës 29.01.2014, lidhur me lëndimet trupore të dëmtuarve, si dhe pranimi i fajësisë ka mbështetje të pa kontestueshme edhe në foto dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka bërë plotësimin e dispozitivave të aktgjykimit, sa i përket dispozitivave blankete, pasi që ka konstatuar se i akuzuari ka ra në

kundërshtim edhe me nenin 225.1 të Ligjit për Sigurinë në komunikacion Rrugor, ku përcaktohen kushtet për Drejtimin e Mjetit, në të cilin thuhet se mjetin me veprim motorik në komunikacion rrugor mund ta drejtoj në mënyrë të pavarur vetëm personi i cili posedon patentë shoferin.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe par. 1 dhe nenit 378 par. 9 lidhur me parë 6 dhe parë 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprat penale nga pakujdesia, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave në rrugë dhe duke mos i kushtuar kujdesin dhe vëmendje e duhur këmbësorëve, në mungesë të eksperiencës në vozitje, për çka edhe janë shkaktuar aksidentet.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për dy veprat penale e cila i vihet në barrë, kishte sjellje korrekte, dhe ndien shumë keqardhje për familjen e të ndjerit B. S. duke ju kërkuar falje, dhe i ka falënderuar për faljen, për herë të parë është gjykuar, i gjendjen së dobët ekonomike-sociale, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, në këtë çështje penal-juridike vlera e mbrojtur është jeta e njerëzve respektivisht kemi të bëjmë me humbjen e jetës së tani të ndjerit-B. S., dhe katër persona të lënduar, një me lëndime të rënda dhe tre me lëndime të lehta, rrethanë tjetër rënduese është fakti se akuzuari në dy aksidentet ka drejtuar automjetin pa i plotësuar kushtet për drejtimin e mjetit (pa patentë shofer), e që rezulton se i kanë munguar njohurit elementare të drejtimit të automjetit dhe rregullave të komunikacionit, Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit, av.F. G.-B. që ti shqiptohet një dënim nën minimumin e paraparë ligjor për veprën penale që ka rezultuar me pasoja fatale dhe për veprën që ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor që ti shqiptohet dënim i kushtëzuar apo i zëvendësuar me gjobë, gjykata nuk e akceptoi, sepse me dënime të tilla kur ka humbje jete dhe me lëndime të rënda trupore si pasojë e aksidentit të shkaktuar nga i akuzuari, nuk arrihet qëllimi i dënimit, e që duhet të ndikoj edhe te tjerët që të përmbahen nga kryerja e veprave të kësaj natyre, nga se kjo gjykatë konsideron se aksidentet e komunikacionit me pasoja fatale në vendin tonë janë në rritje dhe dënimet e shqiptuara në këto raste duhet të

jenë në proporcion me shkallën e lart të rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar u muar në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u muar në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**  
**Pka.nr.165/11,dt.07.03.2016**

**Sekretare Juridike**  
Mihrie Krasniqi-Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.